



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.769/16

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**, nga gjyqtari Avdirrahman Gashi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. L. nga L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.nr.3055/2014 të dt. 16.11.2016, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 28.04.2017 në prezencën e prokurorit të shtetit Blerim Igrishta, dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpallë këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit:

**A. L.**, nga i ati I., i lindur me dt. *data e lindjes...*, me vendbanim në rr. “...”- L., me nr. personal *numri personal...*, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datë 31.03.2014, rreth orës 12:40, në rrugën Lipjan-Janjevë, derisa i pandehuri ishte duke e drejtuar veturën e tipit “Golf”, me targa të regjistrimit *numri i targave...*, ngjyrë e kaltër, nga pakujdesia duke menduar me mendjelehtësi se deri te aksidenti nuk do të vij, ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, e duke vepruar në kundërshtim me nenin 60.2 të LPSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik, dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos pasur kujdes ndaj pjesmarrësve tjerë në komunikacion kishte filluar të bëj gjysmë-kthim nga ana e djathtë në të majtë me pjesën e parë të automjetit godet në pjesën anësore të majtë biçiklistin-të dëmtuarin B. S., ku nga këto lëshime të të pandehurit i dëmtuari B. S. pëson lëndime të rënda trupore,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 7, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, si dhe dispozitave të nenit 365 të KPPK- së të pandehurin e gjykon me,

**DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 2(dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

**I dëmtuari B. S.** me përfaqësuesin ligjor-babain J. S. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të procedurës penale t’ia paguajë, shumën prej 60.88-€, si dhe shpenzimet për paushall gjyqësor shumën prej 20-€, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.nr.3055/2014 të dt. 16.11.2016, e ka akuzuar të pandehurin A. L., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së precizuar dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit nga se pranimi i tillë është i mbështetur në dispozitat ligjore, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, i njëjti e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe njëkohësisht nga gjykata ka kërkuar që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, i njëjti, është mbajtur i familjes 7 anëtarëshe, dhe kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të pandehurin të cilat ndikojnë në zgjedhjen dhe llojin e lartësisë së dënimit, ashtu që, si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi, faktin se i pandehuri është mbajtur i familjes, sinqeritetin e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, rrethanat personale, shkallën e përgjegjësisë penale, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi, dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprën penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u bazua konform nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.769/16 të dt.28.04.2017**

**Sekretarja juridike**

Nexhmije Ahmeti

**GJYQTARI**

Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.